



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në bazë të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (ç), më qëllim të normimit të punës dhe përcaktimit të kriterëve për vendosjen e rezidentëve në Institucionin Special në Shtime, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.12/2004
PËR
PUNËN DHE VENDOSJEN E REZIDENTËVE NË
INSTITUCIONIN SPECIAL NË SHTIME

Neni 1

Qëllimi i udhëzimit administrative

- 1.1** Më këtë Udhëzim Administrativ bëhet normimi i punës dhe përcaktohen rregullat dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve në Institucionin Special në Shtime.
- 1.2** Institucioni Special është me seli në Shtime-Kosovë.
- 1.3** Emërtimi i shkurtër i institucionit special në Shtime do të jetë ISSH.

Neni 2

Institucioni special i shtimes

- 2.1** ISSH është Institucion shtetëror me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

- 2.2** MPMS-ja do të krijojë politikën e deinstitutionalizimit që për synim ka të bëjë me kategorizimin e rasteve dhe të merret vetëm me:
Rastet me retardime të rënda mentale të karakterit social.

Neni 3

Ofrimi i shërbimeve

- 3.1** Në këtë Institucion ofrohen shërbime 24 orëshe:
- a. Ushqim
 - b. Veshëmbathje
 - c. Përkujdesje shëndetësore
 - d. Terapi e punës, edukative dhe aftësuse
 - e. Trajtim social
 - f. Terapi fizikale

Neni 4

Dokumentacioni i domosdoshëm për vendosje

- 4.1** Për vendosjen e personit të retarduar në ISSH i nevoiten këto dokumenta:
- a. Leja e njoftimit ose ndonjë dokument tjetër identifikues.
 - b. Certifikata e lindjes
 - c. Certifikata e mjekut specialist-infektologut
 - d. Mendimi profesional i specialistve të QKU (shkalla e retardimit)
 - e. Dëshmia ligjore se i është marrë zotësia e veprimit
 - f. Dëshmia më shkrim se i është caktuar kujdestaria ligjore jashtë organit të kujdestarisë apo nga organi i kujdestarisë
 - g. Certifikata e gjendjes ekonomike
 - h. Certifikata e gjendjes familjare
 - i. Dy fotografi

Neni 5

- 5.1** Lënda e kompletuar dorëzohet në Divizionin e Institucioneve të DMS-së në MPMS përmes QPS-së.

Neni 6

Komisioni për rishqyrtimin e dokumentacionit për vendosje

- 6.1** Komisioni për pranim është në përbërje nga stafi i Divizionit të institucioneve dhe Institucionit Special në Shtime.
- 6.2** Nëse është e arsyshme Divizioni i institucioneve e bën verifikimin e dokumentacionit dhe e shikon gjendjen faktike në terren.
- 6.3** Vendimi përfundimtar lidhur me kërkesën e rastit merret nga Divizioni i institucioneve përmes drejtorit të Departamentit të Mirëqenies Sociale, duke u miratuar nga Sekretari i Përhershëm i MPMS-së.
- 6.4** Procedura duhet të përmbyllet për tridhjetë (30) ditë.

Neni 7

Marrëveshja me shkrim në mes ish-së dhe organit të kujdestarisë(QPS-së)

- 7.1** Institucioni special në Shtime dhe organi i kujdestarisë (QPS-ja) përkatëse bëjnë marrëveshje me shkrim për koordinimin e punëve përkitazi më përmisimin dhe avancimin e statusit të rezidentve në ISSH.
- 7.2** Marrëveshja duhet t'i përmbajë afatet dhe detyrat që duhet t'i kryej QPS-ja në të mirë të rezidentve.

Neni 8

Kujdestari ligjor

- 8.1** Kujdestari ligjor jashtë QPS-së apo nga QPS-ja, ka të drejtën ligjore të tregojë interesim për rastin e strehuar në Institucionin Special pa u penguar nga askush.

Neni 9

Detyrat e stafit profesional

- 9.1** Stafi profesional i Institucionit special ka për detyrë të përcjellë përparimin e rezidentëve dhe për këtë t'i informojë strukturat përkatëse të MPMS-së.
- 9.2** Stafi profesional i Institucionit special nëse heton përparim te rezidenti në sferën e përkujdesjes vetanake, duhet t'a njoftojë Divizionin e Institucioneve, kujdestarin ligjor me qëllim që të bëhet transferimi në familje, apo në shtëpitë e komunitetit të ndërtuara vetëm për këtë qëllim.

Hyrja në fuqi

Neni 10

- 10.1** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, Maj 2004

**Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi**
